



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Nr. 03/2 Prot.

Lezhë, më 10.3. 2020

VENDIM

Nr. 2, datë 03.03 2020

PËR
SHTYRJEN E MIRATIMIT TË LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR,
PËR QËLLIME IMBOTILIM NË SHISHE OSE ENË, NJËSIA ADMINISTRATIVE
MARTANESH, BASHKIA BULOQIZË, PËR SUBJEKTIN “UJI BALLA”

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 12, neni 41, pikës 2 të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, V.K.M –së Nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre” dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat, Këshilli i Basenit Ujor Mat.

V E N D O S I:

1. Shtyrjen e miratimit të lejes “ Për qëllime imbotilim në shishe ose enë ” subjektit “Uji Balla”, për mbledhjen e radhës së KBU MAT.
1. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm – Erzen – Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Anastasi Meçi



KRYETAR

Gjokë Jaku

